



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
NJESIA E PROKURIMIT

Nr. 6580 / Prot

Shkodër, më 17.04.2025

KONTRATË FURNIZIMI

Blerje kurora me lule per aktivitete te ndryshme te Bashkise Shkoder

E lidhur sot me datë 17/04 /2025, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkoder, e përfaqësuar nga **Z. Benet Beci** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder i përfaqësuar ne kete kontrate me Vendim Delegimi nr. 103, datë 13.03.2025 nga **Z. Alban Preka** në cilësinë e Zv/Kryetarit të Bashkisë Shkoder që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.

Dhe operatorit ekonomik **Arjola Duma Person Fizik** përfaqësuar ne kete kontrate nga **zj. Arjola Duma**, me nr. L77018004Q me Regjistrimi Fillestar me nr. CN-430590-08-17 me seli te shoqerise: Rruga Komiteti i Kosoves, godine 2-kateshe, kati i I-re, nr.9 - Shkoder me tagër dhe kompetencë të plotë për te përfaqësuar operatorin ekonomik në të gjitha marrëdhëniet me investitorin Bashkia Shkodër për realizimin e objektit të kontratës.

Neni 1

Baza ligjore

- Kodi Civil ligji nr.7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 162, dt. 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik",
- VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar
- Ligji nr.48/2014"Per pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" i ndryshuar.
- Udhëzimit nr.30 date 27.12.2011"Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik"

Neni 2

Objekti i kontrates

- Objekt i kësaj kontrate është furnizimi me objekt: "**Blerje kurora me lule per aktivitete te ndryshme te Bashkise Shkoder**" ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike dhe qe **Kontraktuesi** – operatori ekonomik **Arjola Duma Person Fizik** pranon t'i dorezoje sipas ofertes se ofruar dhe pranuar si fituese ne proceduren e prokurimit.

Neni 3

Vlefte e kontrates

1. Kontraktuesi merr persiper te dorezoje tek Autoriteti Kontraktor mallin sipas objektit te lartpermendur ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te dhena ne, kundrejt nje vlere totale prej **240,000** (dyqind e dyzet mije) leke pa tvsh
2. Financimi realizohet nga Buxheti i Bashkise viti 2025.
3. Çmimet e kontraktorit për mallrat e furnizuara sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 4

Afati i kontrates

1. Kontrata do te realizohet sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor nga momenti i nenshkrimit te kontrates deri me 31.12.2025.

Neni 5

Afati dhe kushtet e levrimit

1. Dorezimi i mallrave do te behet brenda afatit te kohezgjatjes se Kontrates sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor.
2. Vendi i dorezimit te mallrave do jete Magazina e Bashkise Shkoder.
3. Dorezimi i mallrave do te behet gjate orarit te punes te Bashkise Shkoder
4. Kontraktuesi duhet te njoftoje Autoritetin Kontraktor 1 (nje) ore para çdo dorezimi te mallrave.
5. Lajmerimi i dorezimit te mallrave do te behet me shkrim, faks, poste, e-mail etj, tek: Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Mbeshtetese.
Tel/Fax: +355673543149
E-mail: burimetnjerezore@bashkiashkoder.gov.al
6. Mallrat do te dorezohen ne vendin e dorezimit te shoqeruara me dokumentat e meposhtme:

Fatura tatimore e mallit

(1 Original)

Neni 6

Ekzaminimi, Inspektimet, Testimet dhe Pranimi i Mallit

1. Perpara pranimit, Autoriteti Kontraktor ka te drejte te egzaminoje, inspektoje dhe testojë mallrat. Ky aktivitet duhet te behet menjehere pas dorezimit te mallrave. Kontraktuesi ka te drejte te marre pjese ne kete aktivitet dhe te shqyrtoje raportet e aktivitetit te pergatitura nga Autoriteti Kontraktor ose agjentet e tij.
2. Kontraktuesi duhet te beje te gjitha testet dhe inspektimet e kerkuara nga dispozitat e Kontrates. Kosto e ketyre testeve dhe inspektimeve duhet te financohet teresisht nga Kontraktuesi brenda kushteve te çmimit te Kontrates.
3. Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka te drejte te ndjeke testimet dhe/ose inspektimet.

4. Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kerkoje Kontraktuesit te beje testimine ose inspektime shtese te paparashikuara ne Kontrate, por te gjykuara te nevojshme per te verifikuar se mallrat jane konform specifikimeve dhe kushteve te Kontrates. Autoriteti Kontraktor do te mbaje pergjegjesi per koston e ketyre testeve. Me tej, nese keto teste ndalojne progresin e punes se Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do te bie dakort te ndryshoje grafikun e levrimet.
5. Autoriteti Kontraktor do te refuzoje mallrat/çdo mall qe nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk eshte konform specifikimeve teknike dhe kushteve te kerkuara ne zbatimin e Kontrates.
6. Refuzimet e perseritura te mallrave/mallit nga Autoriteti Kontraktor, si rezultat i moskalimit te testeve dhe/ose inspektimeve perbejne shkak per zgjidhjen e Kontrates.
7. As ekzekutimi i testeve, as inspektimi i mallrave nuk do te cliroje Kontraktuesin nga çdo garanci ose detyrim tjeter sipas Kontrates.
8. Autoriteti Kontraktor me Urdher te Brendshem ngre **Komisionin per Marrjen ne Dorezim te Mallrave** te kontraktuara.
9. Komisioni i ngritur do te beje verifikimin per sasine e levruar, cilesine, llojin, plotesine e tyre, marken e prodhimit dhe te dokumentacionit shoqerues sipas te gjitha kushteve te percaktuara ne Kontrate si dhe percaktimeve te bera ne Udhezimin nr.30, date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik", per pranimin ose refuzimin e mallit.
10. Per mallrat/mallin qe do te rezultojne konform specifikimeve dhe kushteve te Kontrates, Komisioni, i ngritur sipas pikes 6.8, do te hartoje dhe nenshkruaje **"Procesverbalin e Marrjes ne dorezim te mallrave"**. Ne kete rast, do te veprohet sipas percaktimeve te Udhezimit nr.30, date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik", pikat 42 e ne vijim.
11. Per mallrat/mallin qe nuk do te rezultojne konform specifikimeve dhe kushteve te Kontrates, Komisioni, i ngritur sipas pikes 6.8, do te hartoje dhe nenshkruaje **"Procesverbalin e Refuzimit te marrjes ne dorezim te mallrave"**. Ne kete rast, do te veprohet sipas percaktimeve te Udhezimit nr.30, date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik", pikat 45 e ne vijim.

Neni 7

Kushtet e Pageses

1. Pagesa per mallrat, do te behet brenda 30 diteve nga dita e nenshkrimit nga palet te **"Procesverbalit te Marrjes ne dorezim te mallrave"**. Ne rast se mallrat nuk do te dorezohen ne nje here te vetme, afati i mesiperm fillon nga dita kur do te behet **"Procesverbalit te Marrjes ne dorezim te mallrave"** per mallrat e fundit te dorezuara.
2. Administratori i Kontrates ben miratimin e pageses vetem ne rast se eshte plotesuar dokumentacioni i meposhtem:
Faturen/at tatimore te mallrave, leshuar nga Kontraktues (Ne format elektronik)
Procesverbalin/et e Marrjes ne dorezim te mallit (1 Original)

Aktin e refuzimit te mallit (nese ka sasi malli te refuzuar)

(1 Origjinal)

Flete-Hyrja/et e magazines

(1 Origjinal)

3. Monedha e pageses do te jete: LEKE.
4. Të gjitha pagesat e shumave që i detyrohen Furnizuesit mund të bëhen vetëm në llogarinë bankare të Furnizuesit të paraqitur nga ai vete ne forme shkresore prane Autoritetit Kontraktor .
5. Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”.

Neni 8

Likuidimi per Dorezimin e Vonuar

1. Demet e likuiduara per dorezimin e vonuar do te llogariten me tarifen e meposhtme ditore:
2. Tarifa ditore do te jete 4/1000 te vleres koresponduese te mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontrates, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% te vleres se kontrates.
3. Pagimi i penalitetit nuk e çliron Kontraktuesin nga detyrimet kontraktuale.
4. Penaliteti do te mbahet nga pagesa.

Neni 9

Vonesat ne berjen e pageses

1. Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i voneses ne pagese konsiston ne kamaten e arritur nga data e fillimit te voneses se debitorit (Autoriteti Kontraktor), ne monedhen zyrtare te vendit ku do te behet pagesa. Perqindja e kamates parashikohet me ligj. Ne fund te çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumes totale, mbi te cilen eshte bere llogaritja e tyre.
2. Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) te provoje ndonje dem. Nese kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar nje dem me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet te paguaje pjesen e mbetur te demit.

Neni 10

Garancia

1. Kontraktuesi garanton se mallrat jane te reja, te paperdorura dhe te modeleve te fundit dhe se ato trupezojne permiresimet e fundit ne skicim dhe material.
2. Kontraktuesi mban pergjegjesi per çdo defekt ose mosperputhje qe ekziston ne momentin kur rrisku kaloi tek Autoriteti Kontraktor, edhe kur defekti shfaqet pas ketij momenti.



3. Kontraktuesi mban përgjegjësi për mosperputhjen që verifikohet pas momentit të treguar në paragrafin e mësipërm dhe që vjen nga mospermbushja e ndonjë detyrimi, duke përfshirë garancinë që mallrat duhet të jenë të përshtatshme për përdorimin e tyre të zakonshëm dhe specifik për një periudhë të caktuar kohe, ose se ato do të ruajnë cilësitë dhe karakteristikat e caktuara.
4. Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në Kontratë ose nga ligji, Autoriteti Kontraktor humbet të drejtën e tij për të kundërshtuar për të metat e mallrave nëse ai nuk i denoncon ato të Kontraktuesit, duke specifikuar natyrën e tyre, brenda dhjetë ditësh nga zbulimi i tyre.
5. Autoriteti Kontraktor duhet t'i sigurojë Kontraktuesit të gjitha mundësitë për të inspektuar këto defekte.
6. Pas marrjes së këtij njoftimi, Kontraktuesi duhet të riparojë menjëherë ose të zëvendësojë mallrat me defekt me shpenzimet e tij për Autoritetin Kontraktor.
7. Nëse pas marrjes së njoftimit, Kontraktuesi deshton në rregullimin e defektit brenda një periudhe të arsyeshme, Autoriteti Kontraktor mund të procedojë, me shpenzimet e Kontraktuesit, të ndermarre veprime për rregullimin e nevojshëm.
8. Kontraktuesi nuk mund të shfrytëzojë rregullat e parashikuara këtu nëse defektet kanë të bëjnë me fakte të njohura prej tij ose që nuk mund të ishin të panjohura për të dhe që nuk i janë vënë në dukje Autoritetit Kontraktor.

Neni 11

Forca Madhore

1. Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të Kontrates, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas Kontrates vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
2. Për qëllimet e këtij neni "Force Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor qëofte në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, termeti, epidemitë, shtrengime të karantines dhe embargo tranziti.
3. Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas Kontrates në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kerkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 12

Negociatat dhe Amendamentet

1. Palet nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontrates që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbejnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.



2. Asnje amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoriteti Kontraktor.
3. Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të behen nga palet sipas kontratës duhet të behet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palet që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 13

Nderprerja për Mosplotesim

1. Autoriteti Kontraktor mund të ndërprejë kontratën në teresi ose pjesërisht nëse:
 - a) Kontraktuesi deshton në dorëzimin e mallit brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - b) Kontraktuesi deshton të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
2. Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotesim dhe t'i japë Kontraktuesit 15 ditë të ndreqe mosplotesimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjehershme.

Neni 14

Nderprerja për Shkak të Falimentimit

1. Autoriteti Kontraktor mund të ndërprejë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose behet i paafte të paguajë.
2. Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 15


Nderprerja për Shkak të Interesit Publik

1. Autoriteti Kontraktor mund të ndërprejë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
2. Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë Kontraktuesit lajmerim me shkrim për ndërprerjen.
3. Autoriteti kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Mallrat e pranuar dhe Sherbimet në Lidhje me të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëm të shkaktuar për kryerjen e pjesshme të Mallrave dhe Sherbimeve në Lidhje me të. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesit do t'i kërkojë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëm.

Neni 16

Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

1. Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullorë, urdheresë, urdher ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose



ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 17

Lajmerimet

1. Çdo lajmerim apo njoftim midis Paleve duhet të bëhet me shkrim në adresat përkatëse të Paleve.
2. Njoftimi merr efekt të menjehershëm në momentin e dorëzimit.

Neni 18

Llogaritja e Afateve

1. Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike.

Neni 19

Përgjegjësitë e Furnizuesit

1. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për furnizimin e të gjitha Mallrave dhe Shërbimeve të Lidhura me to të përfshira në Objektin e Furnizimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Neni 20

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

1. Palet e kësaj Kontrate do të bëjnë përpjekje për të zgjidhur në mënyrë paqësore nepermjet negociatave direkte, çdo mosmarreveshje ose konflikt që mund të lindë midis tyre ose lidhur me kontratën.
2. Në rast se palet nuk do të jenë në gjendje t'i zgjidhin mosmarreveshjet ose konfliktet në mënyrë të mesipërme, atëherë secila palë mund t'ia referojë çështjen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 21

Baza Ligjore

1. Kontrata do të qeveriset nga/dhe interpretohet sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë.
2. Për sa nuk është parashikuar në këtë kontratë, do të respektohen dhe zbatohen edhe kushtet e përgjithshme e të veçanta të kontratës të dhëna me dokumentat e tenderit, si dhe dispozitat përkatëse të Kodit Civil në fuqi.

Neni 22

Perfaqësimi i Paleve



- 1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

a)Personi që do të jenë përgjegjës, administratoret e kontrates në emër të **Autoritetit Kontraktor** për ndjekjen e realizimit të shërbimit dhe përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të jene:

z.Hasan Mema Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve Mbeshtetese
cel/tel/fax 0673543149

E-mail:hasan.mema@bashkiashkoder.gov.al

b)Personi që do të jetë përgjegjës, në emër të Kontraktuesit për administrimin e kontrates dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontrates është:

Z. Arjola Duma

Tel. 0694585144

E.Mail: arjo14duma@hotmail.com

- 2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet të dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.
- 4 Në zbatim të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu XIII, neni 107, pika 6, "Zbatimi dhe mbikqyerja e kontratës", në përfundim të kontratës, **z. Hasan Mema** si personi që do të jetë përgjegjës, në emër të Autoritetit Kontraktor për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të përgatisin një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit të kontratës dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti paraqet një informacion për likudimin ose jo të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.
- 5 Struktura përgjegjëse duhet të ndjekë me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës. Personi përgjegjës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:
- a) harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;
 - b) kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;
 - c) administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - ç) sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë dhe afateve, kur është rasti;



- d) menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/ modifikime/ përshtatje të saj;
- dh) raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;
- e) administron kërkesat për ndryshime/ modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
- ë) mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;
- f) përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së

Neni 24

Hyrja ne fuqi e kontrates

1. Kontrata hyn ne fuqi kur plotesohen kushtet e meposhtme:
 - a) Mbas nenshkrimit te saj nga te dyja palet.
2. Kjo kontrate hartohet ne pese kopje origjinale, kater per Autoritetin Kontraktor dhe nje per Kontraktuesin, dhe pasi u lexua, firmoset rregullisht nga palet.

PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR
BASHKIA SHKODËR
Perfaqesuar me vendim delegimi
ZV. Kryetar i Bashkisë
Alban PREKA



PER OPERATORIN EKONOMIK
Arjola Duma Person Fizik
Perfaqesuar nga

Arjola Duma

